

RRETH NESH

Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë dhe Teatri i Kukullave, krijohet, organizohet dhe funksionon në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ligjin nr.10 352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën” ligjin nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, rregulloren e brendshme të Q.K.K.F.T.K-së, si dhe me dispozitat e këtij statuti.

Q.K.K.F.T.K është person juridik, publik, me statusin e institucionit qendror, në varësi të ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën, i pavarur nga subjektet politike dhe grupet e tjera të interesit. Organizohet dhe funksionon sipas strukturës dhe organikës të miratuar urdhër të Kryeministrit pas propozimit të Ministrit të Kulturës.

Numri i punonjësve, Struktura dhe Organika propozohet nga Drejtori i dhe përcillet në organin epror, i cili vazhdon procedurën e mëtejshme të shqyrtimit dhe dërgimit për miratim në institucionet kompetente. Q.K.K.F.T.K-ja drejtohet dhe përfaqësohet nga Drejtori i cili organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e Q.K.K.F.T.K-së dhe përgjigjet para ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën.

Q.K.K.F.T.K ka si mision ruajtjen dhe zhvillimin e vlerave më të mira të teatrit muzikor dhe koreografik, shqiptar dhe botëror, përpunimin krijues të folklorit, nxitjen dhe interpretimin e krijimitarisë bashkëkohore shqiptare, ngritjen teknike dhe profesionale të interpretimit, larminë e individualiteteve interpretuese dhe krijuese, edukimin e publikut me veprat më të mira të teatrit të kukullave dhe krijimitarisë artistike për fëmijë.

Q.K.K.F.T.K -ja, në funksion të përmbushjes së misionit të vet, bashkëpunon me institucionet e shtetit shqiptar, si dhe institucionet ndërkombëtare në fushën e artit dhe kulturës për fëmijë.

Q.K.K.F.T.K në veprimtarinë e saj zbaton strategjinë e Ministrisë së Kulturës në fushën e artit dhe kulturës për fëmijë.

Q.K.K.F.T.K propozon politika nxitëse dhe mbështetëse për zhvillimin e artit dhe kulturës për fëmijë.

Veprimtaria e Q.K.K.F.T.K mbështetet ne:

- a. zhvillimi i artit dhe kulturës;
- b. ruajtja e vlerave kulturore;
- c. realizimin i veprave skenike të autorëve shqiptar dhe të huaj;
- d. eksperimentimi i formave të reja të shprehjes skenike, si festivalet e ndryshme për fëmijë;
- e. ruajtja, zhvillimi, kultivimi i vlerave etnoteatrale si dhe promovimin e tyre brenda dhe jashtë vendit;

Q.K.K.F.T.K ka për detyrë përsosjen e mjeteve shprehëse të interpretimit dhe ekzekutimit muzikor e teatral, bashkëpunimin dhe inkurajimin e inisiativave frytdhënëse që ndihmojnë në realizimin e tij.